



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 07.10.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.09.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "TRIANGLE" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Re-Tender-II-të-Ndërtimi i Qendrës së Biznesit-faza-II-të", Nr. i prokurimit- 632-25-5966-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-028-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "TRIANGLE" SH.P.K., e dt.29.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Re-Tender-II-të-Ndërtimi i Qendrës së Biznesit-faza-II-të", Nr. i prokurimit- 632-25-5966-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-028-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 25.09.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:25.09.2025;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "TRIANGLE" SH.P.K., me dt.29.09.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Re-Tender-II-të-Ndërtimi i Qendrës së Biznesit-faza-II-të", Nr. i prokurimit- 632-25-5966-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-028-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 07.10.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi 1, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale 9.1&9.2, pika a) :

Kërkesa: Një (1) Menaxher te Projektit - Inxhinier i nivelit Master (ose me sistemin e vjetër inxh. i diplomuar) ne Inxhinierinë e Ndërtimit, drejtimi Konstruktiv me 10 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

Dëshmia: Kopja e Diplomës përkatëse, CV e nënshkruar nga inxhinieri/ja, referenca që tregojnë përvojën e kërkuar profesionale, kontratë e nënshkruar ndërmjet punëdhënësit dhe inxhinierit/es për këtë projekt si dhe Vendimi për Menaxher të projektit i nënshkruar dhe vulosur.

Sqarim :

Kandidati i propozuar Karafidin Kuka :

- Ka diplomuar me dt. 05.10.1989 (shiko diplomën) e jo sipas pretendimit nga ana e juaj ne vitin 2003
- Sipas diplomës, referencës dhe CV qe ka prezantuar OE, ky Ing e plotëson në mënyrë të saktë përvojën e punës profesionale pas diplomimit. Dmth i njëjti ka më shumë se 10 vite përvojë pune profesionale të cilën e ka dëshmuar edhe me referencën e prezantuar për vitin 2008-2018 (11 vite).
- **Pretendimi i juaj nuk qëndron.**

Pretendimi 2, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale 9.1&9.2, pika ç)

Kërkesa: Një (1) Inxhinier i nivelit Master (ose me sistemin e vjetër inxh. i diplomuar) ne Inxhinierinë e Ndërtimit, drejtimi Hidroteknikë, me 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

Dëshmia: Kopja e Licencës përkatëse, CV e nënshkruar nga inxhinieri/ja, referenca që tregojnë përvojën e kërkuar profesionale, kontratë e nënshkruar ndërmjet punëdhënësit dhe inxhinierit/es për këtë projekt.

Sqarim :

Kandidati i propozuar Blerina Stublla Statovci :

- Lidhur me përvojën e punës se Ing, Kandidatja e prezantuar ka diplomuar më date 30.07.2020 dhe ka fituar titullin Master i shkencave teknike të ndërtimtarisë, Programi Hidroteknikë.
- Pretendimi i juaj se e njëjta ka prezantuar 2 vite e 10 muaj punë profesionale sipas CV, por e njëjta ka edhe një referencë nga "Suisse company" SH.P.K. në të cilën ka punuar nga 15.12.2019 deri më 30.09.2021 (që nënkupton përvojë pune pas Masterit 1 vit e 2 muaj) me të cilën mbulohet kërkesa, të cilën kandidatja e ka plotësuar në CV pas kërkesës për sqarime shtesë nga ana e jonë.
- Pra përvoja profesionale për 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit plotësohet.
- **Pretendimi i juaj nuk qëndron.**

Pretendimi 3, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale 9.1&9.2, pika e)

Kërkesa: Një (1) Inxhinier i nivelit Master (ose me sistemin e vjetër inxh. i diplomuar) Inxhinierinë Mekanike, drejtimi Termoenegjetikë dhe Termoteknikë, me 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

Dëshmia: Kopja e Diplomës përkatëse, CV e nënshkruar nga inxhinieri/ja, referenca që tregojnë përvojën e kërkuar profesionale, kontratë e nënshkruar ndërmjet punëdhënësit dhe inxhinierit/es për këtë projekt.

Sqarim :

Kandidati i propozuar Gazmend Krasniqi :

- Kandidati i propozuar nga OE i plotëson kërkesat tërësisht sipas kërkesës. Diploma Inxhinjeri Mekanike, Departamenti i Termoteknikës dhe Termoenergjetikës , drejtimi Teknika e ngrohjes dhe termoteknika.
- Drejtimet janë plotësisht me program të njëjte. “Teknika e ngrohjes është identetike me Termoteknikë”.
- **Pretendimi i juaj nuk qëndron.**

Pretendimi 4, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale 9.1&9.2, Lloji i mekanizmit dhe pajisjet

f) Kërkesa: Skele 700 m2

Sqarim :

- OE ka prezantuar kontrate me OE “Fla-Ba Na” për shfrytëzim të 2000 m2 skele. Dëshmia e ofruar nuk e plotëson sasinë e kërkuar prej 700 m2. Pas kërkesës për sqarime shtesë OE i ka prezantuar të gjithë dokumentacionin që vërteton se plotëson kërkesën me 700 m2 skele.
- **Pretendimi i juaj nuk qëndron.**

Pretendimi 5, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale 9.1&9.2, pika f)

f) Kërkesa: Të paktën një nga inxhinierët e kërkuar të jetë i certifikuar për menaxhimin e projekteve - IPMA.

Dëshmia: Licencat përkatëse e lëshuar nga subjektet e licencuar,

Sqarim : Bazuar në kërkesën dhe dëshminë:

Ju keni prezantuar Certifikatë pjesëmarrje në trajnim 15 ditor për Menaxhimin e projekteve të lëshuar nga projekti Kosvet IV dhe Oda Ekonomike e Kosovës. Kjo nuk është certifikatë IPMA dhe as Licencë e lëshuar nga një subjekt i licencuar nga IPMA.

- Licenca duhet të jetë zyrtare e njohur nga IPMA , me logon e tyre dhe e cila lëshohet nga një subjekt i autorizuar. Në dokument duhet të shënohet niveli i certifikimit dhe data e vlefshmërisë.
- **Ky dokument nuk mund të pranohet sepse nuk është certifikim i licencuar IPMA i kërkuar në dosje.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike;

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj



Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;